

RELACION SHPJEGUES

Per projektin: Blerje kënd lojërash për fëmijë F.V

Bashkia Librazhd shtrihet në pjesën lindore të Republikës së Shqipërisë, me një sipërfaqe prej rreth 793.36 km² dhe një popullsi prej rreth 23,312 banorësh, sipas Censurit 2023. Qyteti i Librazhdit përbën qendrën kryesore administrative, ekonomike dhe sociale, ku përqendrohet pjesa më e madhe e aktiviteteve komunitare dhe shërbimeve publike.

Në kuadër të politikave për zhvillimin social dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës, Bashkia Librazhd ka si prioritet krijimin dhe përmirësimin e hapësirave rekreative për fëmijët. Aktualisht, mungesa e këndeve të standardizuara të lojërave kufizon mundësitë për argëtim të sigurt dhe zhvillim fizik e social të kësaj grupmoshe.

Në këtë kontekst, projekti “Blerje dhe instalim kënd lojërash për fëmijë” synon krijimin e një hapësire funksionale, të sigurt dhe bashkëkohore, e dedikuar për aktivitetet rekreative dhe edukative të fëmijëve.

Investimi parashikohet të realizohet në Parkun e Qershive, një nga hapësirat publike më të frekuentuara në qytetin e Librazhdit. Ky park ka një pozicion strategjik dhe aksesueshmëri të lartë për komunitetin, duke e bërë atë një vend optimal për vendosjen e këndit të lojërave. Zona aktualisht përdoret intensivisht nga familjarë, fëmijë dhe të rinj, çka garanton shfrytëzim të menjëhershëm dhe efektiv të investimit.

Sipërfaqja e planifikuar për ndërhyrje është rreth 1152 m² (23 m x 48 m). Projekti parashikon furnizimin dhe instalimin e pajisjeve të lojërave të certifikuar sipas standardeve europiane të sigurisë (EN), të përshtatshme për grupmosha të ndryshme, si dhe trajtimin e sipërfaqes me materiale mbrojtëse, me qëllim minimizimin e rrezikut gjatë përdorimit.

Elementët kryesorë të projektit përfshijnë:

- Loder e kompozuar multifunksionale për fëmijë;
- Loder me dy lisharëse;
- Loder lëkundëse rrotulluese me timon ($D \approx 142$ cm);
- Lodër suste (3 copë);
- Sistemim dhe organizim funksional i planvendosjes së pajisjeve.

Të gjitha pajisjet do të jenë të prodhuara nga materiale rezistente ndaj kushteve atmosferike, me jetëgjatësi të lartë dhe kërkesa minimale për mirëmbajtje. Instalimi do të kryhet në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e sigurisë, duke garantuar përdorim të sigurt për fëmijët.

Realizimi i këtij projekti pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në:

- përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe familjeve;
- rritjen e standardeve të shërbimeve publike rekreative;
- zhvillimin e aktivitetit social dhe komunitar;
- krijimin e një mjedisi tërheqës dhe funksional në hapësirat urbane.

Ky investim është pjesë e programit buxhetor të Bashkisë Librazhd dhe përfaqëson një ndërhyrje të rëndësishme në infrastrukturën sociale dhe rekreative të qytetit.

LODER E KOMPOZUAR



LODER ME DY LISHARESE



LODER LEKUNDESE



RROTULLUESE ME TIMON E D-142 CM



LODER LEKUNDESE



LODER SUSTE (3 COPE)



PLANVENDOSJA E LODRAVE

